



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L-007**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-069 PËR  
AKREDITIM**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-069  
PËR AKREDITIM**

**Neni 1**

1. Neni 2 të Ligjit bazik i shtohen përkufizime të reja si vijojnë:

- 1.1 “**KE**” – nënkupton Komunitetin Evropian.
- 1.2 “**KEE**” – nënkupton Komunitetin Ekonomik Evropian.

**Neni 2**

1. Në nenin 4 të Ligjit bazik pas paragrafit 4. shtohet paragraf i ri me tekstin si në vijim:

5. Ministria përkatëse duhet të sigurojë që organi kombëtar akreditues i tyre i ka burimet e duhura financiare dhe personel për kryerjen e detyrave të tyre, duke përfshirë përmbushjen e detyrave të veçanta, të tilla si aktivitetet për bashkëpunim evropiane dhe ndërkombëtare të

akreditimit dhe aktivitete të cilat janë të nevojshme për të mbështetur politikat publike dhe të cilat nuk janë të vetë-financuara.

### **Neni 3**

1. Në nenin 7 të Ligjit bazik pas paragrafit 1 shtohen paragrafët e rinj me tekstin si në vijim:
2. Organet për Vlerësim të Konformitetit që autorizohen nga Ministrinë relevante, vlerësohen nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës pa qenë të obliguara të akreditohen.
3. Drejtoria e Akreditimit të Kosovës të krijoj, zbatoj si dhe të mirëmbajë sistemin e menaxhimit të cilësisë. Gjithashtu përgatit procedurat për të siguruar menaxhim efikas.
4. Drejtoria e Akreditimit të Kosovës verifikon që vlerësimet janë kryer në mënyrë të duhur dhe të përgatisë raport vjetor, të bëjë publike shpenzimet vjetore të buxhetit si dhe auditimin.
5. Drejtoria e Akreditimit të Kosovës i nënshtrohet vlerësimit të simotrave (për evaluation) respektivisht ekipeve të vlerësimit të cilat do të përcaktohen nga Kooperimi Evropian për Akreditim.
6. Vlerësimi i simotrave funksionon në bazë të kriterëve dhe procedurave transparente të vlerësimit, veçanërisht në lidhje me burimet njerëzore dhe kërkesat e procesit të vlerësimit, fshehtësisë dhe ankesave.
7. Drejtoria e Akreditimit të Kosovës siguron procedurat e duhura të apelimeve kundër vendimeve të marra si rezultat i vlerësimeve të tilla. Pas përmbushjes së këtyre kriterëve dhe procedurave arrihet nënshkrimi i Marrëveshjes Multilaterale me Kooperimin Evropian për Akreditim me ç'rast do të njihen certifikatat për vlerësim të konformitetit nga shtetet anëtare të Kooperimit Evropian për Akreditim

### **Neni 4**

1. Në nenin 9 të Ligjit bazik pas paragrafit 8 shtohen paragrafët e rinj me tekstin si në vijim:
9. Drejtoria e Akreditimit të Kosovës nuk do të ofroj shërbime të cilat ofrohen nga organi për Vlerësim të Konformitetit si dhe të njëjtave nuk do të ju ofroj shërbime konsultative.
10. Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës i lejohej të operoj edhe në territorin e një shteti tjetër me kërkesë të një Organi për Vlerësim të Konformitetit si dhe në marrëveshje me organin kombëtar të atij shteti.
11. Kur një organ kombëtar për akreditim kërkon nga një organ tjetër Akreditues që të kryej një pjesë të aktivitetit vlerësues, certifikata për akreditim do të lëshohet nga organi i cili ka parashtruar kërkesën.

## **Neni 5**

1. Në nenin 14 të Ligjit bazik pas paragrafit 1. shtohen paragrafët e rinj me tekstin si në vijim:
2. Drejtorja e Akreditimit të Kosovës e pranuar si DAK si anëtare në Kooperimin Evropian për Akreditim, do të nënshkruaj marrëveshjen multilaterale me Kooperimin Evropian për Akreditim për pranimin e certifikatave të Akreditimit në mes shteteve anëtare të Kooperimit Evropian për Akreditim
3. Për zbatimin e këtij Ligji dhe të gjitha veprimet të cilat i ndërmerr Drejtorja e Akreditimit të Kosovës duhet të zbatohen dispozitat prej nenit 4 deri në nenin 14 të Rregullores (KE) Nr. 765/2008 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian më 9 Korrik 2008 që ka hyrë në fuqi me 1 Janar të vitit 2010 që përcakton kërkesat për Akreditim dhe mbikëqyrje të tregut që kanë të bëjnë me vënien e produkteve në treg me të cilën shfuqizohet Rregullorja (KEE) Nr. 339/93

## **Neni 6 Hyrja në fuqi**

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-007  
16 qershor 2010**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**